



Procesverbal 10/2024

I mbajtur në mbledhjen e X-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën **28.10.2024** në ora **11.30**, në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për Komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Njoftim nga Zyra e Kryesuesit Xhavit Zariqi (Leutrim Mahmuti) për hapat e ndërmarra për pagesat e mëditjeve të anëtarëve të Komitetit për Komunitete jo shumicë;
5. Planifikim për vizita nga Komiteti për Komunitete në teren dhe
6. Të ndryshme.

Pika 1

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje; prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – U Miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;

Pika 3

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika 4

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Njoftim nga Zyra e Kryesuesit Xhavit Zariqi (Leutrim Mahmuti) për hapat e ndërmarra për pagesat e mëditjeve të anëtarëve të Komitetit për Komunitete jo shumicë;

Leutrim Mahmuti – Kam komunikuar me z. Osmanin, ju si Komitet për komunitete keni kaluar numrin e anëtarëve dhe keni shkel Ligjin për paga, ku thotë se duhet të jetë 30%, kemi komplet dokumentacionin dhe do të paguheni shumë shpejt, mirëpo do të jetë 50€ për mbledhje, ata që i kanë marr më herët nuk do të kthehen retroaktiv.

Florije Islami – Si janë komunat tjera, ata që nuk janë anëtar, të kuvendit.

Leutrim Mahmuti – Paguhen me një ligj të veçantë për anëtarët që nuk janë pjesë e asamblesë komunale.

Hajriz Haziri - Nuk jemi të kënaqur me këtë mëditje.

Leutrim Mahmuti – Me ligj ka të drejt secili komunitet të ketë një përfaqësues në K.K.

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Komuna ka për obligim të krijoj K.K. me anëtar të përkatësisë etnike që jetojnë në Komunën e Ferizajt. Komuna e Prizrenit dhe Shtimes paguhet me nga 180€ për anëtarët e K.K. 8 komuna që kam kontaktua kanë 160€ mesatarisht, e cila shumë është e ligjshme. Duhet të shikojmë një ligj ose të rregullohet që të marrim atë që na takon.

Leutrim Mahmuti – Të gjitha duhet të kalojnë nëpërmes të zyrës së Sektorit të kuvendit por ne nuk kemi zyre të Sektorit të kuvendit. Ne kemi qark mundësi, ju mund të shkoni në thesar që të bisedoni. Çdo gjë që vjenë në mënyrë zyrtare e rregullojmë, për ne nuk është problem.

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Të planifikojmë vizitat ku kemi me shku.

Amir Rexhepi - Ne kemi qenë në vizitë tek shkolla “Shaban Hashani”, mirëpo nuk ka lëvizë ende asgjë. Të ftohet Drejtori i shkollës për të raportuar, për çështjen e kalimit të nxënësve nga shkolla e vjetër tek ajo e reja.

Jehona Mustafa – Kërkoj që të bëhet një takim me ndonjë komunë, për shkëmbim përvojash.

Procesmbajtës


Xhemajl Jashari


Kryesuesi i Komitetit për komunitete
Osman Emini